



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Datë: 15.10.2018

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), shpall këtë:

K O N K U R S I B R È N D S H E M
PËR AVANCIM

Titulli i vendit të punës:	Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP)
Kategoria dhe grada:	Nivel drejtues, koeficienti 10
Numri i konkursit:	APF0004246
Kohëzgjatja e emërimit:	Kohë të pacaktuar (karrierës)
Raporton të:	Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Udhëheqë departamentin dhe cakton objektivat e tij në pajtim me strategjinë dhe objektivat e institucionit dhe harton plane të punës vjetore të detajuara për të përmbushur këto objektiva;
2. Menaxhon stafin dhe buxhetin e departamentit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore që janë relevante me funksionet e departamentit;
3. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
4. Koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të Akademisë, si dhe kujdeset për zbatimin me kohë të detyrimeve financiare;

5. Zhvillon politika lidhur me trajnimin dhe ofrimin e mundësive për ngritje profesionale të shërbyesve civilë në kuadër të Akademisë;
6. Drejton funksionimin dhe administrimin e sistemit për ofrimin e shërbimeve administrative, infrastrukturore, logjistike, mjekësore dhe sistemin e arkivimit të dokumenteve në Akademi;
7. Drejton funksionimin dhe administrimin e sistemit për sigurimin e hapësirave dhe ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative në Akademi;
8. Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohet për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit

Për pozitën, Drejtor i DFSHP-së, **procedura e konkurimit është e brendshme (vetëm për nëpunësit civil ekzistues të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike).**

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare në Juridik, Ekonomik, Shkenca Politike apo Administratë Publike, 7 vite përvojë pune profesionale, përfshirës së paku 4 vite në pozitë drejtuese;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e buxhetit dhe financave, burimeve njerëzore dhe shërbimeve administrative;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, internet)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Përzgjedhja e Drejtorit të DFSHP-së, bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, si dhe Rregulloren Nr.07/2010 për emërimin e nëpunësve civil.

Data e mbylljes se konkursit

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 15.10.2018 deri me datën 22.10.2018 në ora 16:00.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, Zyra e Personelit, dhoma nr.1. kati I, Ndërtesa e re administrative. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurren.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit në numrin e tel: 028 590 070 ext 210 ose 211, prej orës 08:00 - 1600.